



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Numri i Çështjes	31154-05422-80-2018	Data e Regjistrimit	9/7/2018
Numri i Vendimit	80-2018-4702	Data e Vendimit	12/24/2018

### VENDIM NE EMER TE REPUBLIKËS

#### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane E PERBERE NGA:

**KRYESUES:** Gentian Hamiti

**ANËTAR**

**SEKRETARE** Olta Saliasi

**Objekti:** Shfuqizimin e aktit administrativ vendimi Nr.4, dt. 05.01.2018, i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve.  
- Detyrimin e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve t'i riktheje mandatin e deputetit Paditesit, si dhe detyrimin per te shperblyer Paditesin me pagen e deputetit nga data 5.01.2018 deri ne momentin e rikthimit te mandatit te deputetit.

**Baza Ligjore :** Neni 118 i Kushtetutes, Neni 7, 11, 15, 17/1/a, 18, 40/1/a e vijues te ligjin nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", Ligji Nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", Ligji nr. 138/2015

#### Përmbledhja e vendimit:

Vëren:

Se paditësi Aqif Rakipi ka paraqitur para kësaj gjykate kërkespadinë me objekt: Shfuqizimin e aktit administrativ vendimi Nr.4, dt. 05.01.2018, i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve. Detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë për të shpërblyer paditësin me pagën e deputetit nga data 05.01.2018 deri në përfundimin e legjislaturës së nëntë të Kuvendit të Shqipërisë (objekti i ndryshuar i kërkespadisë).

Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se, z.Aqif Rakipi është zgjedhur deputetet në Kuvendin e Shqipërisë, nga lista shumëemërore e Qarkut Elbasan, për legjislaturën e IX.

Në kuadër të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksionet publike", Prokuroria e Përgjithshme ka nisur verifikimet e të dhënave të deklaruara në formularin e vetdeklarimit të deputetit Aqif Rakipi.

Ne daten 18.12.2017, Zyra Interpol Roma ka percjelle prane Zyres Interpol Tirana, pergjigjen e kerkuar nga Prokuroria e Pergjithshme me kete permbajtje: "*Pas krahasimit te gjurmeve te gishtave, Aqif Rakipi eshte raportuar me date 03.11.1998, per vepren penale te marrjes se mallrave te vjedhur, me gjeneralitete Skender Ejylbegaj, lindur me 24.03.1962, regjistruar me 08.10.1996, me gjeneralitet Aqif Rakipi, lindur me 01.04.1964*".



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Me vendimin e datës 26.12.2017, Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur:

*1. Përfundimin e verifikimeve dhe konstatimin se subjekti deklarues z.Aqif Kahraman Rakipi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, përfshihet në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit aktual si deputet, të parashikuara në Vendimin e Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138 viti 2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe për këtë arsye mandati i tij duhet të ndërpritet.*

Në datë 03.01.2018, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka zhvilluar seancën dëgjimore ku z.Aqif Rakipi është përfaqësuar në këtë seancë, nëpërmjet avokatit të tij. Për këtë është mbajtur dhe procesverbali i datës 03.01.2018.

Në vijim, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka marrë vendimin Nr.4, dt. 05.01.2018, me të cilin ka vendosur:

*1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të deputetit z.Aqif Karaman Rakipi...*

*Në këtë vendim, ndër të tjera arsyetohet se: ...Nga verifikimi i të dhënave në Formularin e vetdeklarimit të z.Aqif Rakipi, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë në lidhje me dënim me vendim të formës së prerë nga autoritete gjyqësore shqiptare apo të huaja, dënime me vendime jo përfundimtare nga autoritete gjyqësore shqiptare apo të huaja, masa sigurimi personal, urdhër ndalimi ndërkombëtar, ndalime nga organet ligjzbatuese, dëbime apo hetime brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në formular ka deklaruar vetëm ndryshime në atësi dhe amësi...*

*...Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, referuar gjetjeve të Prokurorisë së Përgjithshme në vendimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr.138/2015 për z.Aqif Rakipi me funksion deputet i Kuvendit të Shqipërisë, konstaton se subjekti z.Aqif Rakipi në këtë rast nuk ka deklaruar gjeneralitete të mëparshme të cilat janë krejtësisht të ndryshme nga gjeneralitetet aktuale. Rezulton se këto gjeneralitete të padeklaruara të rreme janë përdorur nga vetë ai, përpara autoriteteve të Drejtësisë Italiane me të cilat është dyshuar se ka konsumuar veprën penale të marrjes së mallrave të vjedhur. Në këto kushte funksionari publik ka paraqitur rrethana apo të dhëna të rreme në formularët e vetdeklarimit...*

Në këto kushte, paditësi i është drejtuar gjykatës, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur se:

-Paditësi nuk vertetohet se është në kushtet e shkeljes së nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 "Per garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". KQZ-ja veprimtarine e vet administrative në rastin konkret duhet ta kryente në baze dhe për zbatim të ligjit nr. 138/2015,



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

sepse perndryshe aktet e saj nuk sjellin efektet e caktuara juridike. Vlefshmeria e aktit administrativ te KQZ-se presupozon perputhjen e tij me permbajtjen e vet ligjit. Nuk mund te jete i vlefshem nje vendim nese ai nuk perputhet me permbajtjen e ligjit. Nga aktet qe ndodhen ne dosje qartazi nuk rezulton: se paditesi te kete qene i denuar ndonjehere me ndonje vendim te formes se prere apo me vendim jo perfundimtar; nuk rezulton qe paditesi te kete patur ndonje mase sigurimi personal; nuk rezulton se paditesi te jete shpallur ne kerkim nderkombetar, si dhe nuk eshte debuar ndonjehere nga ndonje vend i BE-se apo Shteteve te Bashkuara.

-KQZ, ne procesin e zbatimit te ligjit nr. 138/2018 ka barren e proves te provoje dhe te vertetoje se paditesi eshte ne shkelje te percaktimeve te bera ne nenin 2 te ligjit te sipercituar. Vendimi nr. 4, dt 05.01.2018, bazuar ne shkresen e prokurorit ne asnje rast nuk i referohet dispozitave te ligjit dhe nuk citon asnje reference konkrete ne te. Paditesi nuk ka bere shkelje te qellimshme, sic kerkohet domosdoshmerisht prej percaktimeve te bera ne Vendimin e Kuvendit nr. 17/2016. Hetimi i thelluar i prokurorise ka treguar se paditesi nuk ka qene kurre i denuar, i kerkuar, i debuar apo i arrestuar. Llogjika e thjeshte e do qe mosdeklarimi i perdorimit te identitetit tjetër (gjithnje nese kjo eshte e vertete) eshte e paqellimshme, pasi nese do ta deklaronte nuk do te kishte asnje pengese per te vazhduar mandatin e deputetit, sepse perdorimi i identiteteve te tjera gjate jetes nuk eshte shkak per nderprerje te ushtrimit te mandatit te deputetit. Arsyetimi i KQZ-se, bazuar ne pretendimin e prokurorise, (megjithese i paprovuar) se perdorimi i nje gjeneraliteti tjetër nga paditesi dhe mosdeklarimi i tij ne formular eshte shkak per nderprerjen e mandatit te tij nuk shoqerohet me ndonje arsyetim tjetër qe perse ky mosdeklarim eshte i qellimshem apo pengon verifikimin e tij sipas ligjit.

-Paditesi nuk ka kryer shkelje te ligjit nr. 138/2015 dhe te vendimit perkates te Kuvendit sipas interpretimit te bere nga Kuvendi dhe KQZ-ja per keto dy akte normative. Ky Komision, ne situata te ngjashme, ka refuzuar te nderprese mandatin funksionareve te tjere, nese nuk takohen rastet e ligjit qe cituam me siper. Nderprerje mandati do te kete vetem ne rastet e parashikuara ne ligj dhe jo cdo pasaktesi ne plotesimin e formularit mund te sherbeje si shkak per fillimin e ndjekjes penale sepse per nderprerje mandati as qe mund te diskutohet. Ne rastin konkret, KQZ dhe Prokuroria e Pergjithshme kishte barren e proves ne kete proces dhe disponon cdo mjet te nevojshem dhe te domosdoshem material dhe procedural per ta vertetuar nje gje te tille. KQZ dhe Prokuroria deshtoi te provoje ne rastin konkret se paditesi ka bere fshehje te qellimshme te te dhenave per identitet tjetër ne formular dhe me kete fshehje ka penguar vijimin e hetimeve per personin e tij ne raport me ligjin. Per me teper, theksojme se per paditesin referenca e organit te prokurorise, nuk behet ne mbeshetje te parashikimeve te kushtetutes dhe te



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

ligjit nr. 138/2015, por behet ne lidhje me vendimin e Kuvendit dhe formularin e vetedeklarimit te subjektit vetedeklarues, dhe ne ato pika te cilat sic jane konstatuar me pare nga KQZ-ja, jane ne tejkalim te parashikimeve kushtetuese dhe ligjore.

-KQZ-ja nuk garanoi ne marrjen e aktit administrate per paditesin parimin e procesit te rregullt ligjor. Ne zbatim te ketij parimi ne konstatojme se aktet e depozituara nga Prokuroria dhe qe bazohen ne gjetjet e derguara nga Interpol Roma per paditesin, dukshem jane teper konfuze nga menyra se si jane formuluar dhe nuk shoqerohen nga ndonje dokument procedural. Ne zbatim te procesit te rregullt ligjor ne kete procedim provat duhet te kalojne testin e "dyshimit te arsyeshem" per shkeljen e pretenduar nga ana e paditesit. Konkretisht, mbetet e paplotesuar nga ana dokumentare fakti dhe pro vat se paditesi ka nenshkruar duke perdorur gjeneralitet tjeter sic pretendohet ne vendimin e Prokurorit dhe te KQZ-se. Po keshtu, KQZ duhej domosdoshmerisht te hetonte administrativisht nese ka pas ne ngarkim te paditesit ndonje ceshtje penale, poziten procedurale te deputetit ne ate ceshtje si dhe fatin perfundimtar te kesaj ceshtjeje (gjithnje nese ka). Përsa mësipër padia duhet pranuar si e bazuar në ligj dhe prova.

Pala e paditur, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar se: -Nga verifikimi i te dhenave ne Formularin e vetedeklarimit te z. Aqif Rakipi, rezulton se nuk ka deklaruar (asnje) te dhena ne lidhje me denim me vendim te formes se prere nga autoritete gjyqesore shqiptare apo te huaja, denime me vendime jo perfundimtare nga autoritete gjyqesore shqiptare apo te huaja, masa sigurimi personal, urdher ndalimi nderkombetar, ndalime nga organet ligjzbatuese, debime apo hetime brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Ne formular ka deklaruar vetem ndryshime ne atesi dhe amesi. Duke qene se z. Aqif Rakipi ka qene deputet dhe ne legjislaturen e kaluar te Kuvendit (viti 2009-2013), Komisioni Qendror te Zgjedhjeve ne zbatim te dispozitave te ligjit 138/2015 "Per garantimin e integritetit te personave qe zgjidhen, emerohen ose ushtrojne funksione publike" ka bere verifikimin e te dhenave ne formularin e vetedeklarimit per kete funksionar publike per kete periudhe. Referuar shkreses nr.2452/24 Prot, date 28.07.2016 te Drejtorise se Pergjithshme te Gjendjes Civile, Aqif Rakipi me cilesine e deputetit ka ndryshime ne emer. Sipas aktit te lindjes emri ka qene "Haqif". Prokuroria e Pergjithshme me shkresat nr. 457, date 09.02.2017 dhe me shkresen nr. 2561/2, date 04.10.2017, i ka kerkuar Komisionit Qendror te Zgjedhjeve verifikimin e te dhenave te deklaruar ne formularin e vetedeklarimit per z. Aqif Rakipi. Pas verifikimit te formularit ne perputhje me nenin 15, pika 1 te ligjit 138/2015 dhe Kreu VI, pika 6 Kreu V, pika 3, germa b e Vendimit te Kuvendit 17/2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresen nr. 1025/1 date 14.02.2017 dhe nr. 5641/1 date 06.10.2017 ne te dy rastet vendosi t'ia kaloj rastin per kontroll te thelluar Prokurorise se Pergjithshme. Me shkresen nr.457/3, date



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

26.12.2017, Drejtoria e Marredhenieeve Juridiksionale me Jashte, Sektori i Verifikimit te Integritetit, ka derguar ne Komisionin Qendror te Zgjedhjeve, vendimin e rezultatit te verifikimit per z. Aqif Rakipi, me detyre Deputet i Kuvendit te Shqiperise. Nga "Sektori i Verifikimit te Integritetit te personave qe zgjidhen, emerohen ose ushtrojne funksione publike", me shkresen nr. 454/2 prot., date 17.02.2017, i eshte kerkuar informacion per gjendjen gjyqesore Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve, kurse me shkresen nr.454/3 date 17.02.2017, i eshte kerkuar informacion Drejtorise se Pergjithshme te Gjendjes Civile. Nga pergjigjet e ardhura dhe verifikimet e kryera rezulton se subjekti z. Aqif Rakipi nuk eshte denuar me vendim penal te formes se prere nga autoritetet gjyqesore shqiptare, pra subjekti rezulton "I Padenuar". Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile me shkresen nr. 1417/1 date 24.02.2017 ka vene ne dispozicion te dhenat personale te subjektit, nga te cilat rezulton se z. Aqif Rakipi ka te njejtat gjeneralitete te cilat i ka deklaruar ne formularin e vetedeklarimit. Me shkresen nr.1284/2, prot date 27.12.2016 i eshte kerkuar informacion Zyres Nderlidhese te Policise se Italiane, e cila ka kthyer pergjigje se nga kontrolli ne bazen e te dhenave nuk rezulton qe ky subjekt te jete me precedents penale/policore. Me shkresen nr.1283/1 prot. Date 27.12.2016 i eshte kerkuar informacion Zyres Qendrore Kombetare Interpol Tirana, e cila me shkresen nr.9310/1 prot date 30.12.2016 ka kthyer pergjigje se nga kontrolli ne databazen e te dhenave, nuk rezulton qe ky subjekt te kete qene ne kerkim nderkombetar per kryerjen e ndonje vepre penale. Me shkresen nr.1283, prot date 27.12.2016 i eshte kerkuar informacion Zyres Kombetare Europol, e cila me shkresen nr.89 K prot date 17.01.2017 ka informuar Prokurorine se ne sistemin SIENA nuk rezulton qe subjekti te jete ne kerkim per kryerjen e nje vepre penale. Per nje verifikim sa me te plote dhe te sakte per shkak te mundesise se mbajtjes se gjeneraliteteve te ndryshme nga ato te deklaruar, ne zbatim te nenit 8, pika 6, 8 te ligjit 138/2015, Prokuroria e Pergjithshme i ka kerkuar subjektit te depozitoje gjurmet daktiloskopike prane Drejtorise se Policise Shkencore dhe kjo e fundit nepermjet shkresave nr.977/1 date 21.02.2017 dhe nr.1022/1 prot date 27.02.2017 ka vene ne dispozicion gjurmet daktiloskopike te shtetasit z. Aqif Rakipi. Paralelisht kompania ALEAT sh.a, pas kerkeses nr.455/3 date 20.02.2017 te Sektorit te Verifikimit te Integritetit ka vene ne dispozicion te dhenat daktiloskopike qe ndodhen ne sistemin e kesaj kompanie. Me shkresat nr.158 prot date 10.02.2017, 158/3 prot date 02.03.2017, 1284/8 prot date 22.02.2017 Sektori i Prokurorise i eshte drejtuar me kerkesa Drejtorise se Policise se Shtetit, Zyres Qendrore Kombetare Interpol. Kjo e fundit me shkresat nr.2001/12 prot date 23.03.2017, nr.2001/13 prot date 23.03.2017, nr.2001/KL/26 date 17.10.2017, nr.2001/34 prot date 09.11.2017, nr.2001/38 prot date 07.12.2017, ka kthyer pergjigje se subjekti apo gjurmet daktiloskopike te tij nuk ndodhen te regjistruara ne databazat kriminale te disa shteteve pjese e Interpolit. Me shkresen nr.2001/40/KL prot date 22.12.2017, Zyra Qendrore Kombetare Interpol ka informuar Prokurorine se nga Interpol/Rome/Itali, pas





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

krahasimit te gjurmeve te gishtave ka rezultuar se: "z. Aqif Rakipi eshte raportuar me date 03.11.1998, per vepren penale te marrjes se mallrave te vjedhur me gjenealitetet SKENDER EJYLBEGAJ, lindur me 24.03.1962, regjistruar me 08.10.1996 me gjenealitetet z. Aqif Rakipi, lindur me 01.04.1964".

-Subjekti Aqif Rakipi rezulton se nuk ka deklaruar kete informacion edhe pse ka pasur detyrimin ligjor per ta pasqyruar ne formularin e vetedeklarimit e konkretisht, ne pyetjet 3 "A keni qene ndonjehere ne hetim apo ne gjykim nga nje autoritet i huaj per kryerjen e nje vepre penale?" dhe 4 te formularit, "A keni qene ndonjehere i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese per kryerjen e nje vepre penale". Ai i eshte pergjigjur me "Jo", te dyja pyetjeve me siper. Fakti qe ne formular nuk eshte pasqyruar asnje e dhene e percjelle ne lidhje me ndalimet dhe hetimet perkatese ne shtetin Italian, si dhe me identitetin e rreme te perdoruar nga vete ai, me te cilin eshte dyshuar se ka konsumuar vepren penale te marrjes se mallrave te vjedhur, ben qe subjekti te perfshihet ne kushtet e ndalimit te ushtrimit te funksionit publik si deputet i Kuvendit te Shqiperise. Kjo passjell perjashtimin e menjehershme dhe ne cdo kohe nga funksioni publik qe mban. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar nenit 15 te ligjit 138/2015, Vendimit nr.17/2016 te Kuvendit te Shqiperise, eshte institucioni kompetent per shqyrtimin e rezultateve te verifikimit te Prokurorise se Pergjithshme per z. Aqif Rakipi, dhe ne zbatim te nenit 33 dhe ne vijim te Kodit te Procedurave Administrative, zhvilloi ne seance publike shqyrtimin administrativ per rezultatet e verifikimit te Prokurorise se Pergjithshme. Referuar nenit 33, 42 dhe 47 te Kodit te Procedurave Administrative, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thirri si pale ne kete shqyrtim administrativ, z. Aqif Rakipi, per te dhene mendime dhe shpjegime per faktet dhe rrethanat e ceshtjes.

-Subjekti nuk kane deklaruar informacionet qe lidhen me hetimet ne ngarkim te tyre, pavaresisht detyrimin ligjor qe buron nga pyetja 3 e formularit te vetedeklarimit i cili parashikon: "A keni qene ndonjehere ne hetim apo gjykim nga nje autoritet i huaj per kryerjen e nje vepre penale?". Duke mos i pasqyruar faktet e mesiperme ne formular, konkludohet se veprimi i tyre bie ne fushen e zbatimit te pikes 3/g, te KREUT III, te Vendimit nr. 17/2016 te Kuvendit. Nga shqyrtimi i formularit te vetedeklarimit funksionari ne rubriken 2 te tij nuk ka deklaruar perdorimin e gjenealiteteve te tjera. Sipas rubrikes "B" te formularit funksionari publike ka patur detyrimin te deklaroje gjenealitet te meparshme te ndryshuara zyrtarisht apo qe jane perdorur nga funksionari edhe pa i ndryshuar zyrtarisht. Funksionari z. Aqif Rakipi rezulton se ka perdorur ne shtetin Italian gjeneralitete te tjera te padeklaruara ne Formularin e Vetedeklarimit dhe "raportimi policor" eshte klasifikuar nga Prokuroria e Pergjithshme si hetim ndaj personit nga organet e Drejtesise Italiane per vepren penale te marrjes se mallrave te vjedhur (per rezultatet e hetimit nuk ka informacion). Kreu III, pika 3, germa g parashikon



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

"Formulari i vetedeklarimit permban detyrimisht nje rubrike ku pasqyrohet se.... Pasqyrimi i te dhenave te paverteta te paplota dhe te pasakta ne te passjell perjashtimin e menjehershem dhe ne gdo kohe nga kandidimi/zgjedhja/emerimi apo nga funksioni publik. Ne lidhje me faktin nese mosdeklarimi i te dhenave te cilat parashikohen ne pyetjet e formularit te vetedeklarimit, perbejne shkak per ndalimin e ushtrimit te funksionit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve eshte shprehur rast pas rasti dhe ne vendimet e meparshme ne lidhje me zbatimin e ligjit nr.138/2015.

-Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar gjetjeve te Prokurorise se Pergjithshme ne vendimin e rezultatit te Verifikimit ne zbatim te ligjit 138/2015 per z. Aqif Rakipi me funksion deputet i Kuvendit te Shqiperise, konstaton se subjekti z. Aqif Rakipi, ne kete rast nuk ka deklaruar gjeneralitete te meparshme te cilat jane krejtesisht te ndryshme nga gjenealitete aktuale. Rezulton se keto gjeneralitete te padeklaruara te rreme jane perdorur nga vete ai, perpara autoriteteve te Drejtesise Italiane me te cilat eshte dyshuar se ka konsumuar veprën penale te marrjes se mallrave te vjedhur Ne keto kushte funksionari publik ka paraqitur rrethana apo te dhena te rreme ne formularet e vetedeklarimit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlereson se mos deklarimi ne formularin e vetedeklarimit te gjenealiteteve te tjera, fshehja e tyre, ka qene e qellimshme, per te penguar institucionet e ngarkuara nga ligji 138/2015 per te kryer verifikim te plote dhe te gjithanshem.

-Rezoluta e Kuvendit te Shqiperise "Per vleresimin e veprimtarise se Komisionit Qendror te Zgjedhjeve per vitin 2016". Shprehet se : " Qellimi i ligjit nr.138/2015, eshte te garantoje besimin e pubiikut ne funksionimin e organeve te zgjedhura shtetore, te institucioneve te pavarura dhe atyre te krijuara me ligj, si dhe te administrates publike, nepermjet pengimit te zgjedhjes ose emerimit ne to, apo largimit nga funksioni publik i atyre personave, per te cilet ekzistojne shkaqet ligjore per te mos u kandiduar, per t'u zgjedhur, apo emeruar, por jo te personave qe, per nje arsye qe nuk lidhet me fshehjen e qellimshme, kane referuar te dhena te ndryshme apo te paplota ne raport me te dhenat e gjendura ne regjistrat". Sipas interpretimit te Kuvendit vetem nese fshehja e te dhenave eshte e paqellimshme funksionari nuk eshte ne kushtet per ndalimin e zgjedhjes ose emerimit, apo largimit nga funksioni publik. Qellimi i ligjit 138/2015 shprehet edhe ne procesverbalin e Komisionit te Posagem Parlamentar per Zbatimin e Problematikes ne Rezoluten per Marreveshjen midis Mazhorances Qeverisese dhe Opozites ne Kuvendin e Shqiperise (Dokument Parlamentar), date 20.11.2015, ora 09:00. Ne kuader te zbatimit te Vendimit nr. 17/2016, te Kuvendit te Shqiperise, informacion i ardhur nga institucioni i Prokurorise krijon bindjen se funksionari ka shkelur dispozitat ligjore qe kane te bejne me zbatimin e drejte, transparencen dhe frymen me te cilen funksionon ligji nr. 138/2015 "Per verifikimin e integritetit te personave qe



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

zgjidhen, emerohen dhe ushtrojne funksione publike", dhe rregullimet e detajuara te parashikuara ne Vendimin nr. 17/2016 te Kuvendit te Shqiperise. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vlereson se funksionari publik, deputet i Kuvendit te Shqiperise, z.Aqif Rakipi, referuar gergmes c, pikes 3, Kreut III te vendimit te Kuvendit nr.17/2016, eshte ne kushtet per ndalimin e ushtrimit te funksionit. Referuar nenit 10, pika 1, germa d, kur verifikohen kushtet per moszgjedhje apo moskandidim shpall pavlefshmerine e mandatit dhe perfundimin e parakohshem te mandatit te funksionarit publik

-Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar gjetjeve te Prokurorise se Pergjithshme ne vendimin e rezultatit te Verifikimit ne zbatim te ligjit 138/2015 per z. Aqif Rakipi me funksion deputet i Kuvendit te Shqiperise, konstaton se subjekti z. Aqif Rakipi, ne kete rast nuk ka deklaruar gjenealitete te meparshme te cilat jane krejtesisht te ndryshme nga gjenealitete aktuale. Rezulton se keto gjenealitete te padeklaruara te rreme jane perdorur nga vete ai, perpara autoriteteve te Drejtesise Italiane me te cilat eshte dyshuar se ka konsumuar veprën penale te marrjes se mallrave te vjedhur Ne keto kushte funksionari publik ka paraqitur rrethana apo te dhena te rreme ne formularet e vetedeklarimit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlereson se mosdeklarimi ne formularin e vetedeklarimit te gjenealiteteve te tjera, fshehja e tyre, ka qene e qellimshme, per te penguar institucionet e ngarkuara nga ligji 138/2015 per te kryer verifikim te plote dhe te gjithanshem. Balancimi delikat ndermjet te drejtave te elektoratit pasiv dhe mbrojtjes se funksionimit te mire te administrates publike, eshte nje geshtje qe edhe nga praktika e vendeve te zhvilluara eshte trajtuar deri ne nivel kushtetues dhe konkluzioni ka qene se ka nje interes te pergjithshem publik per te shmangur nje rol aktiv te shkelesve ne vendimmarrjen politike. Interesi publik prevalon ndaj interesave te individeve, qofshin keta edhe te zgjedhur. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas shqyrtimit te rezultateve te verifikimit nga Prokuroria e Pergjithshme vlereson se, per sa i perket procedurave te ndjekura per rezultatet e verifikimit ne lidhje me te dhenat ne formularin e deklarimit, referuar pikes 1 dhe 2 te nenit 8 te ligjit 138/2015 dhe pikes 5 te Kreut V te vendimit 17/2016 te Kuvendit te Shqiperise, eshte kompetence e Prokurorise se Pergjithshme. Përsa mësipër akti administrative, objekt gjykimi është nxjerrë në përputhje me ligjin, dhe për rrjedhojë kërkespadia duhet rrëzuar.

Pala e paditur Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar se: Kuvendi konstaton se kërkesa ne themel te saj ka vendimin e KQZ per shpalljen e pavlefshmerise se mandatit dhe perfundimin e parakohshem te mandatit te kerkuesit si deputet, bazuar ne nenet 6/1, 45, pika 3, dhe 179/a te Kushtetutes, si dhe ne nenet e ligjit 138/2015 "Per garantimin e integritetit te personave qe zgjidhen, emerohen ose ushtrojne funksione publike". Kuvendi vlereson se sanksioni ligjor i nderprerjes se mandatit te paditesit eshte pasoje e drejtperdrejte e parashikimit ne nenin 179/a te Kushtetutes,





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

dispozite kjo kushtetuese qe per sa i perket vete rasteve qe sjellin kete pasoje te referon tek nenet 6/1 dhe 45, pika 3, te Kushtetutes. Ne nenin 10 pika 1, shkronja "d", te ligjit nr. 138/2015, eshte parashikuar se KQZ eshte organi i vetem vendimmarres qe shpall pavlefshmerine e mandatit dhe perfundimin e parakohshem te mandatit te deputetit. Kuvendi gmon se kjo kompetence qe ligji i jep KQZ eshte nje kompetence ekskuzive dhe shteruese dhe vendimi i KQZ ne nje rast te tille i prodhon dhe i shteron plotesisht efektet e tij menjehere, pa pasur nevojten e nxjerrjes se ndonje akti tjeter nga ndonje organ tjeter, perfshire Kuvendin. Per sa me siper, ne kuader te ligjit nr. 138/2015 "Per garantimin e integritetit te personave qe zgjidhen, emerohen ose ushtrojne funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marre vendimin nr. 4, date 05.01.2018.

-Edhe pse paditesi i eshte drejtuar gjykates duke kerkuar detyrimin e Kuvendit te Shqiperise per ta shperblyer me pagen e deputetit nga data 05.01.2018 deri ne perfundimin e legjislatures, terheqim vemendjen ne faktin se midis paditesit dhe Kuvendit nuk ka lindur asnje mosmarreveshje. Paditesi me vullnet te lire i eshte nenshtuar rregullave te parashikuara nga ligji 138/2015 dhe nga Vendimi i Kuvendit 17/2016 "Per percaktimin e rregullave te detajuara mbi zbatimin e ndalimeve te parashikuara ne ligjin nr.138/2015", dhe ka plotesuar Formularin e Vetedeklarimit, e ka dorezuar ate prane KQZ-se, si dhe ka marre dijeni dhe ka pranuar me vullnet te lire edhe sanksionin administrativ te parashikuar ne formular. Sipas Kushtetutes dhe ligjit 138/2015, Prokuroria e Pergjithshme ka verifikuar dhe konstatuar disa fakte te cilat perbejne shkaqe per nderprerjen e mandatit te ish-deputetit, mbi bazen e te cilave KQZ-ja ka marre vendimin per perfundimin e parakohshem te mandatit te kerkuesit. Pra nuk eshte Kuvendi qe de facto dhe de jure i ka dhene fund mandatit te deputetit ne rastin konkret, por eshte KQZ-ja me vendimmarrjen saj. Per rrjedhoje, per sa paraqitur me siper, kerkuesi nuk legjitimohet per te paraqitur pretendime lidhur me detyrimin e Kuvendit te Shqiperise per te shperblyer paditesin me pagen e deputetit nga data e nderprerjes se mandatit deri ne perfundimin e legjislatures. Per kete arsye, bazuar ne nenin 40 te ligjit 49/2012 "Per organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimit e mosmarreveshjeve administrative", kerkojme rrezimin e padise

Personi i tretë, Prokuroria e Përgjithshme, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar se: -z. Aqif Rakipi, si subjekt deklarues, referuar ligjit N138/2015, "Per garantimin e integritetit te personave qe zgjidhen, emerohen ose ushtrojne funksione publike " ka dorezuar nje formular vetedeklarimi te administruar ne date 28.04.2016, ne te cilin nuk ka deklaruar asnje te dhene ne lidhje me vendime penale denimi, masa sigurimi personale, ndalime nga organet ligjzbatuese, debime apo hetime brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Meqenese, kerkesa e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve ka konsistuar ne kryerjen e verifikimit te te dhenave te subjektit



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

deklarues jashte territorit te Republikes se Shqiperise per nje verifikim sa me te plote dhe te sakte per shkak te mundesise se mbajtjes se gjeneraliteteve te ndryshme nga ato te deklaruar, ne zbatim te nenit 8, pika 6, 8 te ligjit 138/2015, Prokuroria e Pergjithshme i ka kerkuar subjektit te depozitoje giurmet daktiloskopike prane Drejtorise se Policise Shkencore. Zyra Qendrore Kombetare Interpol me shkrese zyrtare na informon se nga Interpol/Rome/Itali pas krahasimit te gjurmeve te gishtave ka rezultuar si me poshte: Aqif Rakipi, eshte raportuar me date 03.11.1998, per vepren penale te marrjes se mallrave te vjedhur, me gjeneralitetet Skender Ejlbegaj, lindur me 24.03.1962, regjistruar me 08.10.1996, me gjeneralitetet Aqif Rakipi, lindur me 01.04.1964. Subjekti rezulton se nuk e ka deklaruar kete informacion, edhe pse ka pasur detyrimin ligjor per ta pasqyruar ne formularin e vetedeklarimit e konkretisht, ne pyetjet, 3 “A keni qene ndonjehere ne hetim apo gjykim nga nje autoritet i huaj per kryerjen e nje vepre penale?”, dhe 4 te formularit, “A keni qene ndonjehere i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese per kryerjen e nje vepre penale” Ai i eshte pergjigjur me “Jo”, te dyja pyetjeve me siper. Fakti qe ne formular, nuk eshte pasqyruar asnje e dhene e percjelle ne lidhje me ndalimet dhe hetimet perkatese ne shtetin Italian, si dhe me identitetin e rreme te perdorur nga vete ai, me te cilin eshte dyshuar se ka konsumuar vepren penale te marrjes se mallrave te vjedhur, ben qe subjekti te perfshihet ne kushtet e ndalimit te ushtrimit te funksionit publik si deputet i Kuvendit te Shqiperise. Ne perfundim te verifikimeve eshte konstatuar se subjekti deklarues z. Aqif Karaman Rakipi, deputet Kuvendit te Shqiperise, perfshihet ne kushtet e ndalimit te ushtrimit te funksionit aktual si deputet, qe parashikohen ne Vendimin e Kuvendit Nr. 17/2016 “ Per percaktimin e rregullave te detajuara mbi zbatimin e ndalimeve te parashikuara ne ligjin nr. 138 viti 2015 “Per garantimin e integritetit te personave qe zgjidhen, emerohen ose ushtrojne funksione publike”.

-Vendimarrja e institucionit te Prokurorise se Pergjithshme si organ ligjzbatues eshte bazuar ne Ligjin Nr. 138/2015 dhe rregullimet e detajuara te parashikuara ne Vendimin Nr. 17/2016 te Kuvendit te Shqiperise. Prokuroria e Pergjithshme ne arsyetimin e saj ka zbatuar rigorozisht ligjin Nr. 138/2015 dhe vendimin e Kuvendit 17/2016, dhe vendimarrja e saj eshte e drejte dhe e bazuar, duke mos lene vend per interpretime te tjera

Lidhur me bazueshmërinë e kërkimeve të palës paditëse, gjykata i referohet ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe vendimit unifikues nr.3 datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në vendimin unifikues nr.3 datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është arsyetuar se: *“Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se përgatitja dhe gjykimi e zgjidhja e çështjes nuk mund të*



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

*bazohet vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen "objekti i padisë" dhe "baza ligjore" e saj. Gjykata kur zgjidh mosmarrëveshjen merr në shqyrtim pretendimet e paditësit të cilat parashtrohen në kërkesëpadi si dhe gjatë ushtrimit të së drejtave që rrjedhin nga procesi, duke mbajtur parasysh se konform neneve 5, 31, 154 e 185 të K.Pr.C. objekti i padisë dhe shkaku i saj nuk përmbledhen domosdoshmërisht vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë. Gjykata ka detyrimin të vlerësojë dhe të marrë parasysh të gjithë përmbajtjen e padisë dhe të identifikojë kërkimet e paditësit, në mënyrë që të mund të japë një vendim për to. Pala paditëse ka të drejtë të ngrejë pretendime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që i njeh Kushtetuta apo ligji, ndërsa gjykata, në zbatim të parimit iura novit curia, analizon ligjërisht në mënyrë të pavarur këto pretendime, pa u lidhur me përcaktimin e palëve. Nëse gjykata konstaton se pretendimet e paditësit, d.m.th. objekti i padisë dhe shkaku i saj, gjejnë mbrojtje ligjore atëherë e pranon padinë, në rast të kundërt padia rrëzohet.*

Në këndvështrim të këtij vendimi unifikues, duke marrë në konsiderat përmbajtjen e kërkesëpadisë, shpjegimet si dhe përmbajtjen e pretendimeve përfundimtare të paditësit, gjykata identifikon kërkimin e palës paditëse. Në thelb, kërkitimi i palës paditëse ka të bëjë me shfuqizimin e aktit administrativ, objekt gjykimi, për shkak të paligjshmërisë së tij, si dhe rregullimin e pasojave juridike që ka prodhuar ky akt administrative.

Sic ka rezultuar, z.Aqif Rakipi është zgjedhur deputet në Kuvendin e Shqipërisë, nga lista shumëemërore e Qarkut Elbasan, për legjislaturën e IX.

Me vendimin Nr.4, dt. 05.01.2018, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka vendosur: *1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të deputetit z.Aqif Karaman Rakipi...*

Ky vendim është marrë duke u bazuar në ligjin nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksionet publike", i cili ka për qëllim të tij, garantimin e besimit të publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve (pika 1 e nenit 1 të ligjit nr.138/2015).

Qëllimi i ligjit nr.138/2015 është pasqyruar dhe në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve për vitin 2016", sipas të cilës: "...Qëllimi i ligjit nr.138/2015, është të të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, si dhe të



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

*administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, për të cilët ekzistojnë shkaqet ligjore për të mos u kandiduar, për t'u zgjedhur, apo emëruar, por jo të personave që, për një arsye që nuk lidhet me fshehjen e qëllimshme, kanë referuar të dhëna të ndryshme të paplota në raport me të dhënat e gjendura në regjistrat...*

Në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksionet publike", Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Vendimin nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Ky vendim është autorizuar nga neni 6 i ligjit nr.138/2015, në të cilin parashikohet se:

*Organi kompetent për miratimin e procedurave dhe afateve për administrimin e vetëdeklarimeve 1. Kuvendi miraton me vendim rregullat e detajuara dhe afatet për plotësimin, dorëzimin, administrimin dhe publikimin e vetëdeklarimeve, si dhe për marrjen e masave për zbatimin e ndalimeve të parashikuara nga ky ligj.*

Në rastin konkret, Zyra Interpol Roma ka percjelle prane Zyres Interpol Tirana, pergjigjen e kerkuar nga Prokuroria e Pergjithshme me kete permbajtje: "*Pas krahasimit te gjurmeve te gishtave, Aqif Rakipi eshte raportuar me date 03.11.1998, per vepren penale te marrjes se mallrave te vjedhur, me gjeneralitete Skender Ejylbegaj, lindur me 24.03.1962, regjistruar me 08.10.1996, me gjeneralitet Aqif Rakipi, lindur me 01.04.1964*".

Ky fakt juridik nuk është pasqyruar nga subjekti deklarues Aqif Rakipi, në formularin e vetdeklarimit, kjo në përmbushje të detyrimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Duke qenë se paditësi nuk ka mospasqyruar në formularin e vetdeklarimit, një dënim penal të autoritete gjyqësore të huaja, atëherë ky mosveprim passjell përjashtimin e menjëhershëm të tij nga zgjedhja e funksioni publik, kjo sipas pikës 3 të Kreut III të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit.

Konkretisht, në gërmën ç) të pikës 3 të Kreut III të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit është parashikuar se:

*3. Formulari i vetëdeklarimit përmban detyrimisht një rubrikë ku pasqyrohet se:*

*a) Ky formular përbën dokument zyrtar dhe i nënshtrohet publikimit;*

*b) Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë formular përbën vepër penale dhe*



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

*dënohet me burgim, sipas nenit 190 të Kodit Penal;*

*c) Të dhënat e pasqyruara në të i nënshtrohen një verifikimi të plotë dhe të gjithanshëm, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme;*

*ç) Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik;*

Në mbështetje të këtij vendimi, paditësi ka pasuri detyrimin që të pasqyroj në mënyrë të vërtetë, të plotë dhe të saktë të gjitha të dhënat e kërkuara.

Krahas prezumimit të faktit se paditësi ka qenë në dijeni të detyrimeve të sanksionuara si nga ligji nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ashtu dhe nga Vendimi nr.17/2016 të Kuvendit, sërisht është informuar nëpërmjet përmbajtjes së faqes 2 të formularit të vetdeklarimit, për pasojat juridike lidhur me pasqyrimin e të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta.

Sipas këtij formulari, pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë Formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.

Nëpërmjet këtij formulari, paditësi është informuar dhe për pasojat lidhur me pasqyrimin e të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta. Cka do të thotë se përpilimi i tij në mënyrë të saktë ka një rëndësi esenciale. Duke pasur parasysh rëndësinë e përpilimit të këtij formulari, atëherë mospasqyrimi në formularin e vetdeklarimit, i dënimit me vendim të formës së prerë nga autoritete gjyqësore të huaja, nuk mund të konsiderohet një sjellje e paqëllimshme apo pa pasoja juridike, ashtu sic dhe ka pretenduar paditësi.

Në këto rrethana, vendimi Nr.4, dt. 05.01.2018 i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve është nxjerrë në përputhje me ligjin nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe Vendimin nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim është nxjerrë pas një koordinimi të veprimeve verifikuese të Prokurosë së Përgjithshme, në zbatim të ligjit nr.138/2015, dhe hetimit administrative të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, bazuar në provat shkresore, të cilat janë konsideruar të klasifikuara, dhe në vecanti nga shkresa e datës 18.12.2017, e Zyrës Interpol Roma me të cilën është percjelle prane Zyres Interpol Tirana, pergjigja e kerkuar nga Prokuroria e Pergjithshme me kete permbajtje: "*Pas krahasimit te gjurmeve te gishtave, Aqif Rakipi eshte raportuar me date 03.11.1998, per vepren penale te marrjes se mallrave te vjedhur, me gjeneralitete Skender Ejylbegaj, lindur me*





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

24.03.1962, regjistruar me 08.10.1996, me gjeneralitet Aqif Rakipi, lindur me 01.04.1964".

Po kështu lidhur me procedurën administrative që ka lidhje me nxjerrjen e këtij vendimi, gjykata vlerëson se pala e paditur ka respektuar standartet e procesit të rregullt ligjor, të cilat nuk janë të kufizuara vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter administrativ (vendimi nr.7 dt.27.02.2012 i Gjykatës Kushtetuese). Konkretisht Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka zhvilluar seancën dëgjimore ku z.Aqif Rakipi është përfaqësuar në këtë seancë, nëpërmjet avokatit të tij. Për këtë është mbajtur dhe procesverbali i datës 03.01.2018. Pra paditësit i është dhënë mundësia për tu dëgjuar dhe mbrojtur në këtë procedurë administrative. Në përfundim është marrë vendimi Nr.4, dt. 05.01.2018, me të cilin është vendosur:

*1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të deputetit z.Aqif Karaman Rakipi...*

Përsa mësipër gjykata cmon se vendimi Nr.4, dt. 05.01.2018 i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, është një akt administrativ i nxjerrë në përputhje me ligjin nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe si i tillë duhet lënë në fuqi. Për rrjedhojë kërkimet e palës paditëse duhen rrëzuar, si të pabazuara në ligj dhe prova.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, gjykata arrin në konkluzionin se padia e paraqitur prej paditësit duhet rrëzuar si e pabazuar në ligj dhe prova.

**Për keto arsye:**

Baza Ligjore:

#### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, bazuar në nenet 40, 41, 42 të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", nenet 306-310 të K.Pr.Civile.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Gjykata Administrative e Shkalles se pare**  
**Tirane**

Vendosi:

**VENDOSI**

- Rrëzimin e padisë.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- U shpall sot më datë 17.12.2018, Tiranë.

Ky dokument është marrë nga [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al). Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.